



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 27/11
Prishtinë, më 12.09.2011, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Sali Asllanaj, Hykmete Bajrami, Latif Gashi, Muhamet Mustafa, Albana Fetoshi dhe Xhevdet Neziraj.

Munguan: Duda Balje dhe Hasime Krasniqi.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Ramadan Islami nga GIZ, monitorues nga KDI dhe OSCE.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli dhe Aurora Ademi (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-35 për Riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasuritë e tyre, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-35 për Riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasuritë e tyre, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri**

Kryetarja, theksoi se amendamentet që kanë ardhur nga komisioni funksional nuk përmbajnë implikime shtesë buxhetore, pasi që kostoja për implemtimin e këtij projektligji është përfshirë në Ligjin për Agjencinë e Privatizimit dhe të gjitha shpenzimet janë të përballueshme për buxhetin e Republikës së Kosovës.

Komisioni njëzëri nxorri këtë:

R E K O M A N D I M

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

3. Të ndryshme

Naser Osmani, kërkoi që të shpejtohet diskutimi për agjencionet e pavarura dhe të krijohet një konsensus se si do t'i qasemi këtyre agjencioneve, sa i përket buxhetit dhe pagave të tyre.

Kryetarja, përkrahu parafolesin dhe njoftoi që administrata e komisionit më ndihmën e GIZ-it do t'i nxjerrë të dhënat për të gjitha agjencionet e pavarura dhe të shihet se si janë paraparë pagat dhe si trajtohet stafi me ligj. Propozoi që në fillim të tetorit t'u dërgohet nga një shkresë të gjitha agjencioneve të pavarura që t'i sjellin në Kuvend raportet me të hyrat dhe shpenzimet e detalizuara për nëntë mujorin e këtij viti, në mënyrë që të kemi të dhëna rreth shpenzimit të buxhetit të tyre dhe do të na ndihmonte në vendosjen për buxhetin e tyre.

Hykmete Bajrami, propozoi që të sigurohen të dhëna edhe për shpenzimet e Bordeve të agjencioneve të pavarura, si një element që do të ndihmonte për ta njohur gjendjen aktuale dhe për të parë se si variojnë shpenzimet e Bordit.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

Përqatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadërgjonaj